



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIMAL
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM
NR 75 DATË 17.12.2021

**MBI MIRATIMIN E SHITESË BUXHETI NË MASËN 20,274,913 LEKË
GRANT I PAKUSHTËZUAR DHE GRANT SPECIFIK**

Këshilli i Bashkisë Dimal, në mbledhjen e tij të datës 17/12/2021 ,pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria e Financës,mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”,neni 8 pika 2, 9 pika 1.1.b, Neni 25, Neni 34, Neni 35, Neni 36, Neni 37, Neni 40,Neni 41,Neni 54 pika dh, Neni 55,Neni 64 pika c, Ligji nr.68/2017 “Për Financat e vetëqeverisjes Vendore”, neni 45, Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 44, në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.9 datë 20.03.2018 “Për Procedurat standard të zbatimit të buxhetit” si dhe Udhëzimit plotësues “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”, VKB Nr 81datë 24/12/2020”Mbi Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023 dhe Detajimin e Buxhetit të Bashkisë Ura Vajgurore për vitin 2021“, Aktit Normativ nr. 26 Dt. 23.06.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 137/2020 “Për Buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, Aktit Normativ nr. 34 Dt.03.12.2021 të KM për shtesë buxheti për likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe shtesë në programin specific të rrjetit Rrugor Rural “shkreës Nr 2198/3Prot datë 07/12/2021 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ,shkresës me Nr 21918/4Prot datë 07/12/2021 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

VENDOSI

Me 17 vota PRO nga 17 Këshilltarë prezentë të miratojë :

Të miratojë : Shtesë buxheti në masën 20,274,913 lekë grant i pakushtëzuar dhe grant specifike .

. A. Të miratojë PËrdorimin e shtesës së buxhetit; për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura duke filluar nga detyrimi më i vjetër i papaguar në **masën 10,274,913 lekë sipas programeve**

NR	GRUPI	KAPITULLI	PROGRAMI	SHPEZIMI	VLERA
1	00	01	6260	230	632,000
2	00	01	4240	231	48,600
3	00	01	9120	231	52,800
4	00	01	4520	231	8,167,393
5	00	01	4520	602	1,374,120
	TOTALI				10,274,913

B. Të miratojë Përdorimin e shtesës së buxhetit 10,000,000 lekë për shlyerjen e objektit “Rikonstruksioni i Rrugës Unaza e Re “ në lagjen 28 Nëntori Ura Vajgurore

1	00	01	4520	231	10,000,000
---	----	----	------	-----	------------

Kryetar i Këshillit Bashkiak
Hysen Hoxha



